Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

AMMK

Raport
Mbeturinat e rrezikshme industriale në Kosovë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

AGJENCIA PËR MBROJTJEN MJEDISIT TË KOSOVËS
KOSOVSKA AGENCIJA ZA ZAŠTITU SREDINE
KOSOVO ENVIRONMENTAL PROTECTION AGENCY

Raport
Mbeturinat e rrezikshme industriale në Kosovë

Prishtinë, 2019

Të nderuar lexues,

*Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, ka kënaqësinë të ndajë me Raportin: M*beturinat e Rrezikshme Industriale në Kosovë.

Raporti është përgatitur në kuadër të aktiviteteve për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive ligjore që ka AMMK për raportim të rregullt për gjendjen e mjedisit.

Përgatitja e raportit është mbështetur edhe nga sektorët e tjerë të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Raporti përmban kryesisht të dhëna nga vizitat e realizuara në terren, të AMMK-s, Inspektoratit të Mjedisit apo departamenteve tjera të MMPH-s.

Pjesë e raporti janë edhe të dhënat nga raportet, publikimet apo të dhenat nga organiztat tjera si: operatorët ekonomik, KFOR-i, FSK etj. që kanë realizuar analiza, hulumtime apo kanë bërë identifikimin e materieve të rrezikshme.

Me këtë rast në emër të AMMK-s shpreh falënderim dhe mirënjohje të gjithë atyre që kontribuuan në përgaditjen dhe finalizimin e këtij dokumenti në çfarëdo forme.

Ne i vlerësojmë, i çmojmë dhe i mirëpresim të gjitha angazhimet, vërejtjet dhe sugjerimet e lexuesve të këtij raporti, të cilat do të na ndihmojnë gjatë hartimit të publikimeve të ardhshme, për ngritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së tyre.

Shpresojmë që ky raport do të jetë një kontribut modest, jo vetëm për informimin real për gjendjen e mbeturinave të rrezikshme industriale në Kosovës por edhe një dokument që do ti shërbejë politikbërësve në zbatimin e politikave të qëndrueshme mjedisore dhe donatorëve në orientimin e projekteve të ardhshme.

***Dr.sc. Ilir Morina,** Kryeshef Ekzekutiv i AMMK-së*

PËRMBAJTJA

1. Pjesa Hyrëse 7
1.1. Hyrje 7
1.2. Gjendja e përgjithshme e mbeturinave të rrezikshme 8
1.3. Korniza ligjore 9
1.4. Institucionet përgjegjëse 11
1.5. Përgjegjësit dhe detyrimet e operatorëve 11
1.6. Roli i FSK-s dhe KFOR-it 11
1.7. Forma e menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme në EU 12
1.8. Menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme në Kosovë 13
1.9. Mbledhja dhe trajtimi i mbeturinave të rrezikshme 14
2. Mbeturinat e rrezikshme industriale, lokacionet, sasia, karakteristikat dhe llojet 17
2.1. **Mbeturinat e rrezikshme të grumbulluara dhe magazinuara në Komunën e Obiliqit** 19
2. 1.1. TC Kosova A (KEK) 20
2. 1.2. TC Kosova B 26
2. 2. Mbeturinat e rrezikshme industriale të grumbulluara dhe magazinuara në Komunën e Mitrovicës 30
2. 2.1. Flotacioni-Tuneli i parë 31
2.2.2. Parku Industrial Trepça- Mitrovicë 34
2.3. Mbeturinat e rrezikshme industriale të grumbulluara dhe magazinuara në Komunën e Leposaviqit dhe Zveçanit 38
2.3.1. Flotacioni në Zveçan 39
2.3.2. Flotacioni në Leposaviq 41
2.4. Mbeturinat e rrezikshme industriale të grumbulluara dhe magazinuara në Komunën e Graçanicës 42
2.4.1. Flotacioni Trepça- Kishnicë 43
2.5. **Mbeturinat e rrezikshme industriale të grumbulluara dhe magazinuara në Komunën e Lipjanit** 46
2.5.1. Fabrika për prodhim metali “GC METAL”- Janjevë 47
2.6. **Mbeturinat e rrezikshme industriale të grumbulluara dhe magazinuara në Komunën e Dragashit** 50
2.6.1. Fabrika e tekstilit “SHARRTEX” - Dragash 51
2.7. Mbeturinat e rrezikshme industriale të grumbulluara dhe magazinuara në Komunën e Pejës 54
2.7.1. Swiss General Group Shpk- Ish Kombinati i Lëkurës – Pejë 55
2.7.2. Ndërmarrja e Re”(ish Fabrika e Baterive Industriale Trepça) Pejë 58
2.7.3. Euro Steel” (Ish Kosova Steel) Pejë 61
2.8. Mbeturinat e rrezikshme industriale të grumbulluara dhe magazinuara në Komunën e Gjakovës 64
2.8.1. Metaliku- Gjakovë 65
2.8.2. Emin Duraku i Ri-Devolli Corporation – Gjakovë (ish fabrika e prodhimit të tekstilit Emin Duraku) 68
3. Projektet për përmirësimin e gjendjes së mbeturinave të rrezikshme industriale 71
3.1. Projektet e realizuara 71
3.2. Projektet në zhvillim 71
4. Konkluzione dhe rekomandime 72
5. Referenca 73
6. Shtojcat 73

Lista e tabelave

Tabela 1: Lista e kimikateve të cilat përdoren për trajtimin e ujërave në repartin e P.K.U, TC-A
Tabela 2: Lista e kimikateve të cilat përdoren si reagjentë për analizat e ujërave në laboratorin e përgatitjes kimike të ujit, TEC A
Tabela 3: Materialet që përmbajnë ose dyshohet se përmbajnë azbest që gjenden në hapsirat e TEC A
Tabela 4: Materialet që përmbajnë ose dyshohet që përmbajnë azbest që gjenden në hapësirat e Seperimeve Kimike/TEC A
Tabela 5: Substancat kimike me afat të skaduar të futura në një arkë druri të vendosur në depo/TEC B
Tabela 6: Dozat e rrezatimit të izotopeve në TEC- B
Tabela 7: Mbetjet e rrezikshme me azbest në TC- B
Tabela 8: Materialet që përmbajnë ose dyshohet se përmbajnë azbest që gjenden në hapsirat e DPQ

Tabela 9: Lista e kimikateve në "Flotacioni Trepça"- Tuneli i Parë –Mitrovicë
Tabela 10: Matjet e burimeve radioaktive në "Flotacioni Trepça"- Tuneli i Parë Mitrovicë
Tabela 11: Mbetjet prej procesit teknologjik, lëndë të para dhe kimikatet në Trepçë
Tabela 12: Deponitë e mbetjeve industriale të Trepçës që kanë çasje
Tabela 13: Tabela e matjeve në vendin i cili është me material radioaktiv si Torium, Uranium si dhe Tabela e matjeve të tre kontejnerëve me materie radioaktive Kobalt 60 (Co60)
Tabela 14: Tabela e materieve radioaktive Kobalt 60 (Co60)
Tabela 15: Lista e Kimikateve kimikateve në Zveçan
Tabela 16: Lista e Kimikateve kimikateve në flotacionin në Leposaviq
Tabela 17: Lista e Kimikateve kimikateve në "Flotacioni Trepça"- Kishnicë
Tabela 18: Lista e Kimikateve kimikateve në "GC METAL"- Janjevë
Tabela 19: Lista e Kimikateve kimikateve në "Shartex"- Dragash
Tabela 20: Lista e Kimikateve kimikateve në "Swiss General Group Shpk"- Pejë
Tabela 21: Lista e Kimikateve kimikateve në "Ndërmarrja e Re" (ish Fabrika e Baterive Industriale Trepça - Pejë
Tabela 22: Lista e Kimikateve kimikateve në "Metaliku"- Gjakovë,
Tabela 23: Lista e Kemikateve kimikateve në Emin Duraku i Ri"-Devolli Corporation – Gjakovë
Tabela 24: Lista e projekteve të realizuar për mbeturinat e rrezikshme

Lista e figurave

Figura1: KFOR-FSK-MMPH
Figura.2: Pjestarët e FSK-së në monitorimin e depos mekimikate
Figura 3: Vend-depozitat e Mbeturinave të rrezikshme industriale në Kosovë
Figura 4: Mbeturinat e rrezikshme industriale në lokacionin e TC-A
Figura 5: Vendakumulimet e mbeturinave të rrezikshme në TC-A
Figura 6: Termocentrali i Kosovës B
Figura 7: Mbeturinat e rrezikshme industriale në TC-B
Figura 8: Deponia me mbetje industriale/PIM
Figura 9: Mbeturinat e rrezikshme në lokacionin e Tunelit të parë-Stan Tërg
Figura 10: Mbeturinat e rrezikshme të Tuneli i Parë/Trepça
Figura 11: Mbeturinat e rrezikshme në lokacionin e PIM-Mitrovicë
Figura 12: Mbeturinat e rrezikshme në PIM/Trepçë/Mitrovicë
Figura 13: Mbeturinat e rrezikshme në Zveçan
Figura 14: Mbeturinat e rrezikshme në lokacionin e Kishnicës
Figura 15: Mbeturinat e rrezikshme në Flotacion të Kishnicës
Figura 16: Mbeturinat e rrezikshme në lokacionin e fabrikës "GC Metal"
Figura 17: Mbeturinat e rrezikshme në "GC METAL"- Janjevë
Figura 18: Mbeturinat e rrezikshme në lokacionin e fabrikës "Sharrtex", Dragash
Figura 19: Mbeturinat e rrezikshme në fabrika e tekstilit "Sharrtex" – Dragash
Figura 20: Mbeturinat e rrezikshme në lokacionin e fabrikës "Swiss General Group", SHPK, Pejë
Figura 21: Mbeturinat e rrezikshme në "Swiss General Group Shpk"- Ish Kombinati i Lëkurës – Pejë
Figura 22: Mbeturinat e rrezikshme në lokacionin e fabrikës së baterive industriale
Figura 23: Mbeturinat e rrezikshme në objektin e "Ndërmarrja e Re"(ish Fabrika e Baterive Industriale Trepça) - Pejë
Figura 24: Mbeturinat e rrezikshme në lokacionin e fabrikës "Euro steel", Pejë
Figura 25: Mbeturinat e rrezikshme në "Euro Steel" (Ish Kosova Steel)- Pejë
Figura 26: Mbeturinat e rrezikshme në "Metaliku"- Gjakovë
Figura 27: Mbeturinat e rrezikshme në lokacionin e fabrikës "Metaliku", Gjakovë
Figura 28: Mbeturinat e rrezikshme në ish fabrikën e prodhimit të tekstilit "Emin Duraku", tani "Emin Duraku i Ri"(Devolli Corporation)– Gjakovë
Figura 29: Mbeturinat e rrezikshme në lokacionin e fabrikës "Devolli Corporation", Gjakovë

Shkurtesat

MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
TEC-A	Termocentrali A
TEC-B	Termocentrali B
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
KFOR	Kosova Force
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
PCT	Polychlorinated terphenyls
PCB	Polychlorinated biphenyls
AME	Agjencia e Menaxhimit Emergjent
AKMRRSB	Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Berthamore
EU	Europian Union
BE	Bashkimi Evropian
HWM	Menaxhimi i Mbeturinave të Rrezikshme
BB	Banka Botërore
GIZ	Bashkëpunimi Teknik Gjerman
PIM	Parku Industrial në Mitrovicë
EMKO	Mbetjet nga Procesi i Përpunimit të Zinkut

1. Pjesa hyrëse

1.1.Hyrje

Mbeturinat e rrezikshme industriale të deponuara (magazinuara), në Kosovë, gjinden në vende jo të përshtatshme dhe me rrezik për mjedisin. Në këtë kontekst institucionet dhe publiku akoma nuk kanë njohuri për vendndodhjen dhe rrezikun që paraqesin për mjedisin, shëndetin si dhe për gjendjen aktuale të tyre. Pothuajse, që nga vitit 1999, publikut dhe institucioneve tjera i'u mungon informacioni për mbetjet e rrezikshme industriale të krijuara, deponuara dhe magazinuara në Kosovë.

Prandaj, ky raport synon të ofrojë një përmbledhje të informacionit për mbeturinave të rrezikshme në Kosovë duke përfshirë të dhënat për:

- ✓ Vendmagazinimet dhe depot e mbeturinave të rrezikshme,
- ✓ Përbërjen kimike të këtyre mbeturinave,
- ✓ Llojet dhe informacionet e poseduara për origjinën e vendit,
- ✓ Menaxhimin e tyre
- ✓ Masat e ndërmarra deri më tani për zvogëlimin e rrezikut,
- ✓ Paraqitjen e tyre në harta përmes ortofotove dhe koordinatave.

Është raporti i parë i publikuar në Kosovë i kësaj natyre që ka në fokus mbeturinat e rrezikshme industriale të trashëguara që pas vitit 1999.

Në kuadër të mbeturinave të rrezikshme industriale përfshihen shumë lloje, por në këtë raport janë të përfshirë vetëm mbeturinat e rrezikshme industriale të mbetura dhe të magazinuara me vite të tëra dhe që nuk kanë gjetur akoma ndonjë trajtim adekuat.

Raporti paraqet situatën e përgjithshme të mbeturinave të rrezikshme industriale, gjendjen aktuale të këtyre mbeturinave, formën e menaxhimit, legjislacionin si dhe planin për trajtimin e tyre në të ardhmen.

Raporti posedon informatat të grumbulluara nga institucionet e ndryshme relevante, përgjegjësit për monitorim të mbëturinave të rrezikshme, informacionet nga terreni si dhe harta dhe figura faktike të ilustruara.

1.2. Gjendja e përgjithshme e mbeturinave të rrezikshme industriale

Pas luftës në Kosovë, shumë fabrika dhe reparte industriale ishin shkatërruar dhe demoluar skajshmërisht duke lënë kështu edhe shumë kimikate te rrezikshme si mbeturina. Sasia e këtyre mbeturinave në shumë raste ishte e madhe, ndërkoh që kapacitetet e institucioneve relevante shtetërorë apo edhe operatorët si privatizues të pronave për menaxhimin e tyre ishin të vogla.

Në Kosovë akoma nuk ka një sistem të nivelit të duhur të menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme. Pas vitit 1999 sasi të mëdha të mbeturinave të rrezikshme janë të mbledhura në depo, garazha dhe vende jo adekuate dhe pa ndonjë standard të ruajtjes së tyre. Ato gjinden në shumë rajone të Kosovës. Aktualisht mbeturinat e rrezikshme që kan burime të ndryshme ruhen në objekte të ish fabrikave përkatëse, në magazina dhe depo të një sigurie të nivelit shumë te ulët dhe pa standard. Këto mbeturina janë të sistemuara pa ndonjë kriter dhe vlerësim paraprak. Në shumë raste kur fabrikat apo magazinat e caktuara janë privatizuar, pas procesit të shitjes së kësaj pasurie shtetërore, pronarët e rinj legjitim të cilën i kanë trashëguar këto mbeturina, nuk kanë arritur të gjejnë zgjidhje adekuate për asgjësimin e tyre.

Përkundër monitorimit të vazhdueshëm dhe mbajtjes nën kontroll të mbeturinave të rrezikshme industriale nga ana e Inspektoriatit të MMPH- së, KFOR-it dhe FSK-s ato çdo herë paraqesin rrezik permanent për mjedisin dhe ekosistemin në tërësi deri sa të bëhet asgjësimi i tyre përfundimtar. Përkundër shumë hulumtimeve nga institucionet monitoruese të lartëcekura akoma nuk mund të flitet saktë për përbërjen dhe llojin e këtyre mbeturinave të rrezikshme, shkallën e rrezikshmerisë në mjedis, dhe impaktin në shëndet.

Akoma nuk ka studime të detajuara për të gjitha llojet e këtyre mbeturinave, me përjashtim të disave që janë marrë si informacione nga KFOR-i, FSK-ja dhe inspektoriati i MMPH-së.

1.3.Korniza ligjore

MMPH ka hartuar një kornizë ligjore të mjaftueshme për mbrotjen e mjedisit dhe shumica e këtyre ligjeve janë në harmoni me standardet e BE-së. Në kuadër të insfrastrukturës ligjore mjedisore janë hartuar ligje dhe akte nën ligjore edhe për rregullimin e problematikës së mbeturinave të rrezikshme dhe kimikateve.

Korniza ligjore për mbeturinat e rrezikshme në kuadër të legjislacioni aktual që ndërlidhet me mbeturinat e rrezikshme përfshinë:

- LIGJI Nr.03/L-025 PËR MBROJTJEN E MJEDISIT;
- LIGJI Nr. 04/L-060 PËR MBETURINA;
- LIGJI Nr. 04/L-197 PËR KIMIKATE;
- LIGJI Nr. 03/L-042 I PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE;
- LIGJI NR.03/L-119 PËR PRODUKTET BIOCIDE;
- LIGJI NR. 04/L -190 PËR PRODUKTE DHE PAJISJE MEDICINALE.

Aktet nënligjore në të cilat mbështetet menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme janë:

- Udhëzimi administrativ nr. 13/2013 Për katalogun Shtetëror të mbeturinave, nënshkruar me datë: 24.06.2013
- Udhëzimi administrativ nr.20/2012 Për eksport, import dhe tranzit të mbeturinave, nënshkruar me datë: 10.08.2012.
- Udhëzimi administrativ nr.05/2013 Për menaxhimin e vajrave të përdorura dhe mbeturinat me vajra, nënshkruar me datë: 21.03.2013.
- Udhëzimi administrativ nr.16/2013 Për Vlerat kufitare të përqëndrimeve për komponentet e rrezikshme në mbeturina, nënshkruar me datë: 12.07.2013.
- Udhëzimi administrativ nr. 22/2013 Për administrimin e mbeturinave medicinale humane dhe veterinare, nënshkruar me datë: 07.11.2013
- Udhëzimi administrativ nr. 25/2014 Për administrimin e mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike, nënshkruar me datë: 27.11.2014.
- Udhëzimi administrativ nr. 26/2014 Për mbeturinat nga bateritë dhe akumulatorët e shpenzuar, nënshkruar me datë: 27.11.2014.
- Udhëzimi administrativ nr. 05/2015 Për menaxhimin e bifenileve dhe trefenileve të polikloruara dhe mbeturinave me PCB dhe PCT, nëshkruar me datë: 26.05.2015.
- Udhëzimi administrativ nr. 15/2015 Për administrimin e mbeturinave nga gypat fluoreshent që përmbajnë merkur, nëshkruar me datë: 23.11.2015.
- Udhëzim administrativ nr. 22/2015 Për administrimin e mbeturinave që përmbajnë azbest, nënshkruar me datë: 18.12.2015..
- Udhëzimi administrativ nr. 02/2017 Për listën e kategorive të mbeturinave të rrezikshme sipas origjinës, nënshkruar me datë: 02.05.2017.
- Udhëzimi administrativ nr. 13/2017 Për menaxhimin e mbeturinave Medicinale-Patologjike, nënshkruar me datë: 22.08.2017

- Udhëzimi administrativ nr.14/2017 për menaxhimin e mbeturinave që përbejnë materie me ndotës organik të qëndrueshëm, nënshkruar me datë: 06.09.2017
- Udhëzimi administrativ nr.10/2011 për pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme.
- Udhëzimi administrativ për listën teknike të sigurisë për kimikate, përmbajtjen dhe mënyrën e plotësimit të saj.
- Udhëzim administrativ nr 07/2014 për kompetencat e zotëruesit të mbeturinave prodhuesit dhe importuesit të produktit

*Sqarim: Mbeturinat e rrezikshme karakterizohen dhe klasifikohen sipas katalogut shtetëror të mbeturinave dhe shënohen me kodin 6 shifror dhe me *.*

1.4. Institucionet përgjegjëse

Autoritet kompetent për administrimin e mbeturinave të rrezikshme është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë. Përgjegjësitë dhe detyrimet për menaxhimin e mbeturinave janë dhënë në nenin 16 të Ligjit për Mbeturina nr. 04/L-060, ku përshkruhen përgjegjësitë dhe detyrimet e zotëruesit të mbeturinave.

1.5. Përgjegjësitë dhe detyrimet e operatorëve

Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturinat (nenin 16, 17, 18 dhe 20), janë përcaktuar detyrimet për menaxhimin e mbeturinave për zotëruesit e mbeturinave, prodhuesit dhe importuesit e produkteve, transportuesit dhe operatorët për trajtimin e mbeturinave.

Disa nga detyrimet e operatorit për trajtimin e mbeturinave janë**:**

- ✓ Të hartoj planin për menaxhimin e mbeturinave në impiantin për trajtim apo përpunim, sipas nenit 12 të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturinat dhe të siguroj zbatimin e tij;
- ✓ Të kryej aktivitetet për trajtimin e mbeturinave në përputhje me kushtet e përcaktuara në licencë;
- ✓ Të menaxhoj impiantet, pajisjet dhe aparaturat për trajtimin e mbeturinave, në harmoni me udhëzimet dhe standardet teknike;
- ✓ Të mbaj dhe ruaj evidencën në regjistrin për mbeturina në pajtim me dispozitat e këtij ligji;
- ✓ T`i lejoj qasje të lirë organit kompetent për kontrollin dhe mbikqyrjen e lokacionit, objektit, impiantit, pajisjeve dhe të kontrollojë dokumentacionin për menaxhimin e mbeturinave;
- ✓ Të autorizoj personin e kualifikuar për kryerjen e punëve profesionale;
- ✓ Në rast aksidenti, menjëherë të njoftoj organin kompetent, në përputhje me ligj.

1.6. Roli i FSK-së dhe KFOR-it

Roli i FSK-së i KFOR-it dhe institucioneve tjera me ekipet profesionale që janë të involvuara në monitorimin dhe inspektimin e mbeturinave të rrezikshme është një aktivitet kyç në kontrollimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të tyre.

Monitorimet dhe inspektimet e para nga KFOR-i në bashkëpunim me MMPH-në, janë bërë që nga viti 2004. Në këtë aktivitet janë identifikuar vendet e mbeturinave të rrezikshme në Kosovë. Në ndërkohë kontributi i FSK-KFOR-it, ishte i domosdoshëm për shkak të posedimit të mjeteve mbrojtëse për mbeturinat e rrezikshme por edhe në identifikimin e tyre për shkak të kuadrove të specializuara për këto materie të rrezikshme. Me ndihmën e tyre janë bërë sanime, grumbullime, paketime, ri ambalazhime si dhe etiketime për materiet e rrezikshme që janë vendosur nëpër ambiente të mbyllura të depove të ndryshme.

Kontrollimi i këtyre mbeturinave të rrezikshme vazhdon edhe më tutje me pjesëmarrjen e FSK-së, KFOR-it, AME-së, AKMRRSB-së (shih fig.1 dhe 2).

Fillimisht numri i vendëdepove me mbeturina të rrezikshme ishte 23 dhe tani në 2017 është reduktuar në 17. Këto inspektime janë të rregullta dhe të gjitha këto lokacione i nënshtrohen inspektimit 2 herë brenda vitit. Pas çdo inspektimi hartohen raporte për vlerësimin e gjendjes së përgjithshme, jepen udhëzimet e sigurisë dhe vlerësohet niveli i rrezikshmërisë në zonë.



Fig.1. *KFOR-FSK-MMPH*



Fig.2. *Pjestarët e FSK-së në monitorimin e depos me kemikale1*

1.7. Forma e menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme në EU

Mbeturinat e rrezikshme janë mbetje me veti të rrezikshme ose të afta të kenë një efekt të dëmshëm për shëndetin e njeriut ose mjedisin. Mbeturinat e rrezikshme gjenerohen nga shumë burime, siç janë proceset industriale etj. dhe mund të vijnë në shumë forma, duke përfshirë lëngjet, gazrat, të ngurta dhe llumrat.[2]

Për planifikimin dhe trajtimin e mirë të mbeturinave të rrezikshme, praktika të mira i gjejmë në shtetet anëtare të BE-së. Praktikat e mira në këto vende janë si rezultatet i njohurive për trajtimin e këtyre mbeturinave, përvojës dhe mjeteve të nevojshme për trajtim. Në kuadër të praktikave të mira të menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme hyjnë një seri procesesh të cilat janë të ndërlidhura në mënyrë zingjirore. Me ndërprerjen e njërës prej këtyre hallkave të menaxhimit, procesi nuk do të ishte efikas.

Në kuadër të këtij procesi hyjnë;

- ✓ Planifikimin e menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme dhe kapacitetet e trajtimit,
- ✓ Klasifikimi i duhur i mbeturinave të rrezikshme,
- ✓ Grumbullimi, ruajtja dhe etiketimi i tyre i saktë,
- ✓ Trajtimi i tyre me teknologjinë më të mirë,
- ✓ Forma e inspektimit dhe monitorimit,
- ✓ Cilësia e të dhënave, mbajtjen e shënimeve dhe procedurat e raportimit,

[1] Raporti i inspektimit KW2-2018-KFOR/FSK
[2] https://www.epa.gov/hw/learn-basics-hazardous-waste#hwid

- ✓ Bashkëpunimi dhe komunikimi i mirë me institucionet relevante, komunitetin e bizneseve dhe publikun.

Por në përgjithësi menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme është përgjegjësi kombëtare e secilit shtet, me përjashtim të lejeve të cilat lëshohen nga autoritetet lokale për menaxhimin e këtyre mbeturinave që kanë rrezikshmëri të vogël. Në secilin shtet evropian menaxhimi i mbeturinave duke përfshirë edhe ato të rrezikshme janë të përfshirë në legjislacionin kombëtar.

Menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme në vendet e BE–se bëhet duke respektuar disa parakushte si:

- ✓ Klasifikimi i mbeturinave të rrezikshme,
- ✓ Specifikimet në etiketim të mbeturinave që e obligon mbajtësin e materialit,
- ✓ Sistemi i menaxhimit të regullimit të mbeturinave funksionon dhe menaxhohet nga Zyra Kombëtare/ Ministrit apo agjencitë përkatëse,
- ✓ Çdo njëri që është i përfshirë në menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme është i pajisur me leje nga autoritetet kompetente,
- ✓ Zyra Kombëtare e Lejeve për Grumbullimin e Mbeturinave regjistron dhe i jep të gjitha lejet për mbledhësit e mbeturinave, dhe një regjistër elektronik është publikisht i disponueshëm.

1.8.Menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme në Kosovë

Mbeturinat e rrezikshme në Kosovë janë gjeneruar nga sektorë të ndryshëm. Shumica dërmuese e këtyre mbeturina të rrezikshme janë krijuar para vitit 1999, dhe të njejtat akoma deri me sot nuk kanë gjetur trajtim.

Edhe pse këto mbeturina janë të magazinuara në vende të papërshtatshme dhe jo adekuate, akoma insitutcionet komunale dhe qëndrore nuk kanë krijuar një sistem të mirëfillt për menaxhimin e tyre. Edhe pse këto monitorohen në përiudha të ndryshme kohore nga MMPH, FSK dhe KFOR, ato në çdo moment paraqesin një rrezik të madh si për mjedisin ashtu edhe për shëndetin e qytetarëve.

Forma e menaxhimit dhe ruajtjes së këtyre mbeturinave të rrezikshme është mjaftë e vështirë përshkak të aftësisë koroduese që kanë. Në anë tjetër objektet ku janë të lokalizuara këto mbeturina janë të pa përshtatshme dhe të pa mbrojtura nga ndonjë fatkeqësi, mungesës financiare për trajtim e deri te forma e tyre e mbetjes pa pronar. Edhe pse pas privatizimit të reparteve apo aseteve industriale ku bënin pjesë edhe këto mbeturina të rrezikshme, kostoja për t'i trajtuar këto mbeturina nga ana e operatorëve është e pa përballueshme.

Nevoja për ndërtimin e një objekti për ruajtjen e të gjitha mbeturinave të rrezikshme është-i e domosdoshme deri në zgjidhjen e këtij problemi. Si objektivë për ndërtimin e këtij objekti është përmendur edhe në shumë dokumente të MMPH, si në Planin e Veprimit për Mjedisin në Kosovë 2006-2010, i konfirmuar edhe më tej në Strategjinë e Mjedisit të Kosovës dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Mjedisin për 2011-2025 si dhe në Strategjinë e Menaxhimit të Mbeturinave 2013-2022.

Një përgjigje për financimin e këtij objekti është marrur nga fondet e BE-së, fond i cili do të ndihmon në ndërtimin e këtij objekti në afërsi të aeroportit të Prishtinës në Harilaq. Këtë e ka garantuar vendimi i Qeverisë së Kosovës i marrur më datën 29.05.2018, ku është përcaktuar lokacioni për ndërtimin e objektit për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme në Kosovë. Në këtë lokacion lejohet magazinimi i mbeturinave të rrezikshme në Komunën e Fushë Kosovës, pjesa kadastrale në Harilaq me parcelat kadastrale në pronësi të Agjencisë së Pyjeve të Kosovës, parcela me ID të njëjsisë kadastrale P-72514003-00022; P-72514003-00022; P-72514003-00022; P—72514003-00022-19. Edhe pse nga ana e Qeverisë së Kosovës është marr një vendim për ndarjen e parcelës, ky objekt ka të ngjarë të mos ndërtohet në këtë vend përshkak të kundërshtimit nga Komuna e Fushë Kosovës dhe reagimeve të shumta të shoqërisë civile.

1.9.Mbledhja dhe trajtimi i mbeturinave të rrezikshme

Bazuar në inspektimin e përditësuar dhe informacionin në dispozicion, kjo situatë vazhdon të ekzistojë për shkak të paqartësisë për kushtet e pronësisë mbi ndërmarrjet shoqërore dhe mungesa e hapësirës adekuate për mbledhjen dhe ruajtjen e duhur të lëndëve të rrezikshme dhe materialeve. Përveç këtyre sasive të konsiderueshme të materialeve është e rëndësishme gjithashtu të theksohet se ka materiale të rrezikshme të krijuara në mënyrë të vazhdueshme duke përfaqësuar kështu një rrezik të madh për njerëzit dhe mjedisin në përgjithësi.

Në bazë të vëzhgimeve, inspektimeve dhe të dhënave të fituara, mund të zbulohet se industrialisht zonat e zhvilluara janë ato që kanë përqendrim të madh të materialeve të rrezikshme. Një përqendrim i madh është i pranishëm në Mitrovicë (Trepça), Kishnicë (Trepça) dhe KEK-Kastriot, pa neglizhuar edhe vende të tjera, si Ferronikeli Kompania, Bateritë-IBG në Gjilan, fabrika e auto-pjesëve në Pejë, IMK-Ferizaj, Farmakos-Prizren etj.

Në Kosovë, akoma nuk ka asnjë depo ose impiant ekskluziv që do të trajtonte apo të ruante mbeturinat e rrezikshme sipas standardeve të BE. Mënyra e trajtimit dhe pajisjet teknologjike për trajtimin e mbeturinave të rrezikshme janë të ndryshme dhe specifike varësisht se për cilin lloj është fjala. Prandaj, forma e mbledhjes dhe trajtimit të tyre kërkon një kujdes të veçantë duke vlersuar ndjeshmërin e tyre në rast të ndonjë aksidenti. Më ndihmën e KFOR-it dhe TMK-së u bënë shumë operacione për uljen e rrezikut, duke bërë disa aktivitete për mbledhjen e tyre në ambientet e ndryshme të objekteve të mbyllura, paketimin dhe ripaketimin e këtyre materialeve të rrezikshme. Meqenëse trajtimi dhe ruajtja në vende të sigurta kërkon kosto të lartë, në kushtet e tanishme qoftë në aspektin infrastrukturor apo edhe profesional do të ishte e pamundur që të respektohet ndonjë standard. Meqenëse MMPH dhe institucionet tjera shtetërore janë përgjegjëse për krijimin e kushteve për trajtim të këtyre mbeturinave, një hap drejt zgjidhjes së këtij problemi do të ishte një rrugë të mbarë që përfundimisht të gjen zgjidhje ky problem.

Mbeturinat e rrezikshme gjinden në forma dhe ambalazhime të ndryshme, që sipas informatave që posedojmë janë tretës organikë, ngjyra, llaçe të ndryshme, substanca ngjitëse, tretës për metale, tretës kimikë (me karakter acid ose alkaline), por edhe substanca tjera të panjohura. etj. Ky volum i mbeturinave me etiket të njohur dhe të pa njohur për llojin, trajtimin dhe asgjësimin e tyre, kërkon një profesionalizëm të lartë si dhe të jetë nën menaxhimin strikt të MMPH dhe insituticioneve tjera monitoruese.

Prandaj në këtë drejtim MMPH po zhvillon politikat e duhura për të të bërë një trajtim të duhur të këtyre mbeturinave. Një mbështetje të duhur është duke marrur edhe nga institucionet ndërkombetare dhe donator si BE, BB dhe GIZ, në mënyrë që mbeturinat e rrezikshme të gjejnë tretmanin e duhur.

Në këtë drejtim MMPH do të:

- ✓ Mbështet dhe lejojë heqjen e mbeturinave të rrezikshme nëse nuk ka mundësi për ripërdorim të tyre.
- ✓ Mbështetë, ndihmojë dhe lejojë investitorët për të ndërtuar ndonjë objekt ose pajisje për trajtimin e mbeturinave të rrezikshme, si: furrat moderne për djegien e HWM, pajisjet për rigjenerimin dhe riciklimin e mbetjeve të rrezikshme në dobi materiale.
- ✓ Krijon një sistem të qëndrueshëm për menaxhimin e HWM, duke hartuar legjislacionin dhe planet për menaxhimin e HWM.

- ✓ Zhvillimi i aktiviteteve për eksplorimin, përcaktimin e vendndodhjes dhe ndërtimin e një zone qëndrore magazinimi për ruajtjen e tyr në mënyrën më të sigurtë.
- ✓ Mbështet dhe lehtëson krijimin e një operatori HWM dhe trajnimin e personelit përkatës që duhet të jetë përgjegjës për të trajtuar mbetjet e rrezikshme të prodhuara, të eksportuara dhe të importuara përfundimisht në territorin e Kosovës.

Gjithashtu mbeturinat e gjeneruara nga pajisje të ndryshme të tilla si: kondensatorë me PCB dhe PCT, tregues të tymit, niveli matësit dhe instrumentet e ndryshme me pjesët e tyre që lëshojnë rreze radioaktive, pjesë të ndryshme elektronike, tuba fluoreshente dhe pjesë të tjera të kontaminuara duhet të vendosen në vende të sigurta derisa ato të trajtohen, eliminohen ose si struktura të dëmshme për t'u shkatërruar ose ruajtur në mënyra të përshtatshme.

2. Mbeturinat e rrezikshme industriale, lokacionet, sasia, llojet dhe karakteristikat

Gjatë viteve të fundit është bërë një formë e Inventarit të burimeve kryesore të mbeturinave të rrezikshme industriale të patrajtuara në Kosovë. Ky inventar vazhdimisht azhurnohet dhe integrohet në statistikat e MMPH/AMMK, përmes databazës së krijuar në këtë institucion. Që nga viti 2004-2009, MMPH, KFOR dhe FSK kanë punuar në drejtim të identifikimit të këtyre pikave me mbeturina të rrezikshme në Kosovë.

Në këtë periudhë kohe përpos identifikimit, është bërë një punë e madhe edhe në pastrimin, grumbullimin, paketimin, shënimin dhe vendosjen e mbeturinave të rrezikshme në ambiente të mbyllura duke i mundësuar shmangien e kontaktiti direkt me to. Fillimisht, numri i këtyre pikave me këto substanca të rrezikshme ishte 23 sosh, dhe tani (2017) ky numër është zvogëluar në 17 qendra. Dy qendra me këto substancat të rrezikshme gjinden në Zveçan dhe Leposaviq, dhe inspektohen rregullisht drejtpërdrejt nga KFOR-i duke qenë e vështirë qasja e zyrtarëve të MMPH.

Tani mbeturinat e rrezikshme të vendosura në ambientet e mbyllura inspektohen në mënyrë të përhershme nga Inspektoriati i MMPH, KFOR FSK, Agjencisë për Mbrojtjen nga Rrezatimi Jonizues, Sigurinë Bërthamore dhe Emergjenca, sipas një plani dinamik në bazë mujore dhe vjetore.





***Fig.3**. Vendëdepozitat e mbeturinave të rrezikshme në Kosovë*

2.1.Mbeturinat e rrezikshme të grumbulluara dhe magazinuara në Komunën e Obiliqit



2.2.1. TC Kosova A (KEK)

Përshkrim i shkurtër

Kimikatet të cilat gjinden ne TC-A janë të paraqitura në tabelat në vijim. Këto kimikate janë të deponuara në enë përkatëse dhe të shenjëzuara, dhe të gjitha shpenzohen 100%. Pra, nuk ka mbetje të kimikateve te cilat janë në TC-A. TC-A ka ndërtuar një stacion të përhershëm të hidrogjenit dhe të CO_2. Bombolat e hidrogjenin janë të vendosura në mënyre statike ku nga aty drejtpërdrejtë bëhet furnizimi i tij me qëllim të kryerjes se procesit së ftohjes. Bombolat nevoiten të mbulohen me ndonjë kulm apo strehë i cili do të mund t'i mbrojë ato nga temperaturat e larta.

Ndërrimi i filtrave të oxhaqeve është përfunduar në vitin 2013. Filtrat e rinj janë në kufijtë e lejueshëm 35-50 mg pluhur/metër katror, gjë që është në përputhje me standardet minimale evropiane. I gjithë hiri tani transportohet në mënyrë hidraulike deri në vendin e hedhjes përmes tubacionit. Objekti i ri i transportimit hidraulik të hirit është funksional dhe po punohet në pyllëzimin e hapësirave në kuadër të projektit të rikapitalizimit. Në hapësirat e TC-A-s ka një numër të madh të objekteve të vjetra dhe të skrapit, për çka KEK-u duhet të bëjë sanimin e tyre.

Me një vendim të menaxhmentit të KEK-ut janë ndaluar të gjitha furnizimet me përbërje të azbestit. Është formuar një komision brenda TC-A për inventarizimin e të gjitha materialeve me përbërje të azbestit, grumbullimin e tyre dhe deponimin e përkohshëm deri në deponimin e përhershëm nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Burimet radioaktive. Agjensioni për Mbrojtje nga Rrezatimi Jonizues dhe Siguri Bërthamore ka bërë Inventarizimin e të gjithë izotopeve dhe janë dhënë numra identifikues. Kryesisht lloji i izotopeve është Kobalt 60 (Co60) dhe Cezium 137 (Cs137), të cilat janë vendosur në bunker. Sipas AMRRJSB të gjitha izotopet që gjinden në bunker janë të kategorisë 5 gjë që nuk shkaktojnë kontaminim të ambientit. Ekipi i FSK-së së bashku me ekipin e MKAB-së nga KFOR-i Gjerman kanë bërë matjen e hapësirave të brendshme dhe të jashtme të bunkerit me burime radioaktive. Leximet tregojnë vlera normale, bunkeri është i rrethuar, i shenjëzuar, dhe i mbyllur si dhe nën kujdes të sigurimit fizik. Matjet e treguara në ambientet e jashtme të bunkerit tregojnë vlera normale të sfondit natyror.

Kushtet e përgjithshme në gjithë kompleksin janë ende të dobëta, kryesisht për shkak të vjetërsisë. Hapësirat e brendshme të punës në ndërtesat e turbinave aktive janë të pastra dhe pa mbeturina. Përmirësimi më i madh sa i përket sigurisë ishte instalimi i aparateve të zjarrëfikjes të modelit 5 lb deri 30 lb në të gjitha ndërtesat.[3]

[3] **Burimi**: Raporti i ekipit inspektues në përbërje nga KFOR, FSK, AKMRRSB, AME dhe MMPH-**2018**

Veprimtaria

Prodhimi i energjisë elektrike

Tabela 1. *Lista e kimikateve të cilat përdoren për trajtimin e ujërave në repartin e P.K.U, TC-A*

Nr.	**Emri i Kimikatit**	**Rez./Silos(T)**	**Sasitë Max.**
1	Acid Klorhidrik (Hci)31-33%	16	2x50=100(M^3)
2	Hidroksid i Natriumit (Naoh)40-45%	9.5	3x25=75 (M^3)
3	Gelqere e Hidratizuar Ca(Oh)	69	6x60=360 (M^3)
4	Aktifos	645 Fuqi	
5	Hidrazin Hidrat (Levoksin)	4.46	
6	Dioksid Karboni(Co2)	Bombola	Sipas Nevojës
7	Hidroghen	Bombola	Sipas Nevojës
8	Hidroksid i Kaliumit		150kg/Vit
9	Dyoksid Klori, Komponenti A (Nacl+Aditiv) Komponenti B ($Nahso_4$+Na_2S2o_8	260 Litra	
10	Inhibitor -Stabilizator i Fortësisë së Ujit ËTCË 1364 K	32	
11	Aditiv për Sistemin e Transportit Hidraulik të Hinit, Përbërja(Trefosfat i Natriumit, Granula + Acid Fosforik 85% + Acid i Limoni Monohidrat 99.5%)	5.5	
12	Sulfati I Hekurit (Fe_2SO_4)	15.98	Lokacioni Prugofc

Tabela 2. *Lista e kimikateve të cilat përdoren si reagjentë për analizat e ujërave në laboratorin e përgatitjes kimike të ujit.-TEC-A*

Nr.	**Emri i kimikatit**	**sasitë**	**Nr.**	**Emri i kimikatit**	**sasitë**
1	Klorur Magnezi - $Mgcl_2$	0.5 Kg	48	Jodur i Zhivës	75 Gr.
2	Oksalat Natriumi - Nac_2O_4	1.4 Kg	49	Karbonat Bariumi --- $Baco_3$	Ska Fare
3	Kalium Permanganat Kmno4	5 Kg	50	Sulfat Bakri --- $Cuso_4$	1 Kg
4	DIKLOR MANGAN - $Mncl_2X4h_2O$		51	Alfa 1 - $C_{10}H_8N_2$	5 Gr.
5	Natrium Azid - Nan_2	500 Gr.	52	Mureksid Indikator	200 Gr.
6	Sulfat Mangani -$Mnso_4$	5 Kg	53	4-Dimetil Aminobenzaldehid	1 Kg
7	Karbonati Bazik i Plumbit -($Pbco_2$) $Xpb(Ch)_2$	4 Kg	54	Amidon	2 Kg
8	Kloruri i Bariumit - $Bacl_2$	2 Kg	55	Klorur Natriumi	10 Kg
9	Kloruri i Kaliumit - Kcl	3.5 Kg	56	Alkool Etilik	7 Lit.
10	Fenantralin - $C_{12}H_{18}N_2Xh_2O$	30 Gr.	57	Aceton	3 Lit.
11	Klorur Hidroksidamoni - $Honh_3Cl$	1 Kg	58	Metanol	2 Lit.
12	4-Dimetil Benzaldehid - $C_9H_{11}No$	2 Kg	59	Acid Limoni	1 Kg.
13	Acid Oksalik $C_2H_4O_4X2h_2O$	4 Kg	60	Nitrat Argjendi - Ampula 0,1n	Ska Fare
14	Jodur Kaliumi - KJ	8 Kg	61	Acid Sulfurik 1N	Ska Fare

15	Natrium Tetraborat	Ska Fare	62	Hidroksid i Natriumit 0,1n	Ska Fare
16	Indikator Eriokrom i Zi - T	400 Gr.	63	Natrium Tetraborik	Ska Fare
17	Kompleksoni -Iii-	4 Kg	64	Pirogalloll	2 Kg
18	Parametil Aminofenol - Sulfat	250 Gr.	65	Kalium Dikromat	5 Kg
19	Kalium Cianid - Kcn	3.5 Kg	66	Natrium Tio-Sulfat	1 Kg
20	Oksid Bakri - Cuo	200 Gr.	67	Fenolftalein -Indikator	1.5 Kg
21	Sudan - III-	Ska Fare	68	Nitrat i Zhivës - $Hg(No_3)_2$	100 Gr.
22	Kalium Hidrofosfat	500 Gr.	69	Hidrazin Sulfat	800 Gr.
23	Indikator Metil Blu	100 Gr.	70	Bikarbon i Natriumit	3 Kg
24	Diklor i Bakrit	1.5 Kg	71	Amonjak 25%	7 Lit.
25	Acid Tartarik (VENE)	Ska Fare	72	Klorur Amoni	2 Kg
26	Natriumi Bisulfit	200 Gr.	73	Klorur Mangani	250 Gr.
27	Nitrat Amoni	200 Gr.	74	Glicerin	Ska Fare
28	Klorur Zingu	Ska Fare	75	Acid Fosforik	Ska Fare
29	Baker Elementar	200 Gr.	76	Acid Nitrik 65%	2 Lit.
30	Toluidin		77	Tretje Puferike Ph=7	3 Lit.
31	Reagens për Amonjak - Wessler	100 Gr.	78	Tretje Puferike -9	3 Lit.
32	Indikator Metil Oranzh	200 Gr.	79	Tretje Puferike - 4	2 Lit.
33	Sulfat Bakri	200 Gr.	80	Tretje Puferike - 10	4 Lit.
34	Nitrat Argjendi	Ska Fare	81	Amonium Heptamolibdat	2 Kg
35	Klorur i Zhives	Ska Fare	82	Natrium Sulfit Ampula 0,1N	Ska Fare
36	Kallaj (Granula)	100 Gr.	83	Metoll	1.5 Kg
37	Oksalat Amoni	250 Gr.	84	Kloroform	3 Lit.
38	Kalium Natrium - Tartarat	250 Gr.	85	Triplex Ampula 0,1N	Ska Fare
39	Natrium Bisulfat	250 Gr.	86	Etil Metilketon	
40	Etil Acetat	2 Lit.	87	Nitrat Zhive 99%	250 Gr.
41	Peroksid Hidrogjeni	2 Lit.	88	Feri Amonjumsulfat	1 Kg.
42	Tretje Standarte E Jodit	2 Lit.	89	Tetra Klorur Karboni	Ska Fare
43	Jod Kristale	Ska Fare	90	Kalium Hidrofosfat	500 Gr.
44	Acid Borik	1 Kg	91	Perisulfat i Amonit	15 Kg
45	Indikator Blu 6b		92	Acid Klorhidrik 37%	10 Lit.
46	Acid Pikrik	300 Gr.	93	Hidroksid i Kaliumit	3 Kg
47	Dioksid Plumbi	750 Gr.			

Tabela 3. *Materialet që përmbajnë ose dyshohet se përmbajnë azbest që gjenden në hapsirat e TEC A*

Nr.	**Lloji i MPA-s në TC Kosova A**	**Njësia**	**Sasia**
1	Lesh xhami (pajisjet ngrohëse të kazantoreve: A1, A2, A3, A4, A5)	m^3	5,225
2	Izolimi i mbështjellësve statorik	kg	670
3	Gërsheta puthitësh (shnurë)	copë	686
4	Pëlhurë qelqi, δ = 3 (mm)	m^2	178
5	Puthitës të ndryshem	kg	700
6	Puthitsa tjerë	copë	150
7	Cement azbesti (lesonit) mbules kulmi	m^2	13,242

8	Masa rrethore nga azbesti ("fillc")	copë	3
9	Tabelë nga azbesti me dimensione: 100 X 100 X 0.5 (mm)	copë	5
10	Pëlhurë asbesti	kg	200
11	Valvula të ndryshme me MPA	copë	1,655
12	Dredhë (shnjurë)	kg	771
13	Lesh xhami rreth rezervarëve të ndryshëm	m^2	55,700
14	Shtof(Pëlhurë) azbest	m^3	50

Tabela 4. *Materialet që përmbajnë ose dyshohet që përmbajnë azbest që gjenden në hapësirat e Seperimeve Kimike/TEC A*

Nr.	**Lloji i MPA- Departamenti i ndarjes kimike-(DSK)**	**Njësia**	**Sasia**
1	Cement azbesti (lesonit)-mbules kulmi	m^2	13421.52
2	Lesh xhami	m^2	9.922
3	Hedhurina të ndryshme	m^2	96.25
4	Pllaka dyshemeje, PVC	m^2	2422.16
5	Puthitës të ndryshëm	copë	5480
6	Thurrëse	kg	1230
7	Rrobat e zjarrëfikësve nga azbesti	palë	15

Në TC-A ndodhen 5 transformator që dyshojmë se përmbajnë vaj të kontaminuar me përmbajtje të PCB-s. Pesha e transformatorëve është 18.7 t, ndërsa pesha e vajit është 4.62 t. Aktualisht 2 prej këtyre transformatorëve janë ende në operim.

Në repartin e ndarjes kimike (DSC) janë 5 transformator që dyshohet se përmbajnë vaj të kontaminuar me PCB, pesha e këtyre transformatorëve është 13.8 t, kurse pesha e vajit është 4.16t, nga këta njëri transformator është ende në operim.

** Vërejtje: sasitë e vajit duhet marrë si relative për shkak se trafot që janë jashtë përdorimit nuk dihet sasia e tyre, ndërsa trafot që janë në përdorim duhet vërtetuar sasia dhe përmbajta.*

Lloji i rrezikut në zonë				
☒ Rrezik për shpërthim	☒ Korroziv	☒ Helmues	☐ Infektues	☒ Radioaktiv




***Fig.4**. Mbeturinat e rrezikshme në lokacionin e TC-A*



Fig.5. *Vendakumulimet e mbeturinave të rrezikshme në TC-A*

2.1.2. TC Kosova B

Përshkrim i shkurtër

Në një depo të TC-B, janë të vendosura një sasi e materieve kimike që shfrytëzohen për proceset e ndryshme gjatë prodhimit të energjisë elektrike. Vajrat dhe kimikatet të ndryshme në këtë depo janë sistemimi nëpër rezuervuar të plastikës dhe metalit. Mirëpo, është e nevojshme që të bëhet një inventarizim, sistemim dhe riambalazhim i kimikateve. Në këtë depo gjithashtu gjinden disa transformator jashtë përdorimit të cilët në vete përmbajnë një sasi të konsiderueshme të vajit pirulen. Edhe pse matjet nga detektoret kimik nuk kanë sinjalizuar për ndonjë rrezik, megjithatë rekomandohet të mos qëndrohet brenda ambienteve të depos për shkak të vetive të rrezikshme kimike që kanë këto materie.
Në TC-B, janë të vendosura edhe 3 rezervuar statik me hidrogjen, në vendin ku kryhet procesi i elektrolizës. Gjithashtu janë të vendosur edhe dy rezervuar të mëdhenjë me kapacitet 60 ton të cilat njëri është me NaoH dhe tjetri me HCl.
Në hapsirat e TC-B gjinden 4 izotope radioaktive të cilat gjenden tek lokacioni "Ura e pjerrët" dhe ato janë: 2 Americium 241, dhe 2 Cezium 137.
Këto izotope bëjnë identifikimin e lagështisë së qymyrit i cili bartet përmes shiritit të thëngjillit. Rrezatimi në këtë hapësirë nuk paraqet rrezik për punëtorët, mirëpo prapë është e rekomanduar që personeli të qëndroj sa më pak në afërsi të tij. Rezultatet e matjeve i takojnë normave të lejuara dhe nuk paraqesin rrezik.(shih tab. 6). Gjithashtu në funksion janë edhe 3 izotope tjera radioaktive (Cezium 137) të cilat kanë funksionin e matjes së dendësisë së hirit.[4]

Veprimtaria

Prodhimtaria e energjisë elektrike

***Tabela 5**. Substancat kimike me afat të skaduar të futura në një arkë druri te vendosur në depo/TEC B*

Nr	Kimikati	Sasia	Nr	Kimikati	Sasia
1	Muroksid	11x25 gr	22	KNO_3	3 x 250 gr
2	$HgCl._2$	10x250 gr	23	Nessler	29 x 100 ml
3	HgJ_2	6x25 gr	24	$KMnO_4$	33 x 250 gr
4	$HgNO_3$ x H_2O	18 x50 gr	25	KCN	4 x 250 gr
5	$MnCl_2$ x $4H_2O$	20x250 gr	26	KSCN	12 x 250 gr
6	$MnSO_4$ x H_2O	24 x 250 gr	27	K_2CO_3	5x 250gr
7	$AgNO_3$	24 x100 gr	28	K_2CrO_4	9 x 250 gr
8	NaS_2O_5	5x250 gr	29	Ca CO_3	9 x 250 gr
9	Na_2SO_3x $7H_2O$	1x 250 gr	30	KJ	25 x 250 gr
10	$NaNO_3$	7 x 250 gr	31	Komplekson III	28 x 100 gr
11	Na_2CO_3	1x 250 gr	32	Dimetilaminobenzo aldehid C6H11NO	240 x 100 gr

[4] **Burimi**: Raporti i ekipit inspektues në përbërje nga KFOR, FSK, AKMRRSB, AME dhe MMPH-**2018**

12	Na_2 S x5H_2O	3x250 gr	33	CuCl	17 x 250gr
13	Na H2 PO4 x H2O	8x250gr	34	Difenil karbozon C13 H12 N4O	130 x 5 gr
14	Mg Cl_2 x 6H_2O	2x250 gr	35	Erio hrom i zi T	35 x 25 gr
15	Amidon	3 x 850 gr	36	Acid oksalik C_2 H_2O_4	20x 250gr
16	Indikator Pufer Tableta	14x500 cop	37	Amonjum Nitrat	9 x 250 gr
17	Hekur Amino Sulfat	40 x 250gr	38	Dyetilditiokarbomit I natriumit N6H10NNaS2x 3 H2O	75 x 10 gr
18	FeCl3 x 6H2O	8 x 250gr	39	Natrium Pirosulfat Na2S2O5	50 x 250 gr
19	KH_2PO_4	8 x 250gr	40	Amonjum molibdat (NH4)2MoO4	10 x 250gr
20	$CaCl_2$ x H_2O	7 x 250 gr	41	Tio Sulfat i Natriumit Na2S2O3	20 x 250 gr
21	KCl	3 x 250 gr			

Tabela 6. *Dozat e rrezatimit të izotopeve në TEC- B.*

Nr.	**Vendi**	**Hyrja**	**1 m**	**2 cm**	**Data e matjeve**	**Ora e matjeve**	**Materia Radioaktive**	**Vërëjtje**
1	Ura e Pjerrët	0.12 µsv/h	0.12 µsv/h	0.259 µsv/h	14/02/2017	10:45	Burim i Paidentifikuar*	Matjet janë bërë në afërsi të burimit – Dozë e ulët
2	Ura e Pjerrët	0.12 µsv/h	0.12 µsv/h	0.260 µsv/h	14/02/2017	10:48	Burim i Paidentifikuar*	Matjet janë bërë në afërsi të burimit – Dozë e ulët
3	Ura e Pjerrët	0.12 µsv/h	0.55 µsv/h	185.3 µsv/h	14/02/2017	10:50	Cezium 137	Matjet janë bërë në afërsi të burimit 2 cm – Dozë e lartë
4	Ura e Pjerrët	0.12 µsv/h	0.50 µsv/h	380.7 µsv/h	14/02/2017	10:55	Cezium 137	Matjet janë bërë në afërsi të burimit 2 cm– Dozë e lartë
5	Të filtrat Hinizimi	0.09 µsv/h	0.0198 µsv/h	1.12 µsv/h	14/02/2017	10:30	Cezium 137	Matja në afërsi të burimit - Dozë e ulët
6	Të filtrat Hinizimi	0.09 µsv/h	0.0298 µsv/h	0.14 µsv/h	14/02/2017	10:33	Cezium 137	Matja në afërsi të burimit - Dozë e ulët
7	Të filtrat Hinizimi	0.09 µsv/h	0.0238 µsv/h	1.17 µsv/h	14/02/2017	10:39	Cezium 137	Matja në afërsi të burimit - Dozë e ulët

Tabela 7. *Mbetjet e rrezikshme me azbest në TC- B*

Nr.	Lloji i MPA në TC Kosova B	Njësia	Sasia
1	Mbulesa e kulmit (lesonit)	(m²)	2,199
2	Kllapa për përshtatje	(kg)	48,022
3	Pluhur azbesti	(kg)	3
4	Pllaka të përshtatshme	(kg)	599
5	Asbest (amianti)	(kg)	328
6	Ngjitës mbrojtës	(copë)	262

Tabela 8*. Materialet që përmbajnë ose dyshohet se përmbajnë azbest që gjenden në hapsirat e DPQ*

Nr.	Lloji i MPA në DPQ- Divizioni i Prodhimit të Qymyrit	Njësia	Sasia
1	Mbulesa e çatisë (lesonit)	m^2	18,030
2	Lesh xhami (izolim rreth gypave të ngrohjes)	m^2	2,840

Lloji I rrezikut në zonë				
☒ Rrezik për shpërthim	☒ Korroziv	☒ Helmues	☐ Infektues	☒ Radioaktiv



Fig. 6*. Termocentrali i Kosovës B*



Fig.7. Mbeturinat e rrezikshme industriale në TC-B





2.2. Mbeturinat e rrezikshme të grumbulluara dhe magazinuara në Komunën e Mitrovicës



***Fig.8**. Deponia me mbetje industriale/PIM*[5]

[5] Raport:Hotspotet mjedisore në Kosovë, MMPH/AMMK,2012

2.2.1. Flotacioni-Tuneli i parë

Përshkrim i shkurtër:

Në këtë lokacion bëhet përgatitja e koncentratit të Pb dhe Zn, me çrast përdoret një sasi e kimikateve siç janë: Gëlqerja, Sulfati i Bakrit, Sulfati i Zinkut, Nitrati i Natriumit etj. Këtu ndodhen dy depo, njëra me kemikate (reagensë), dhe tjetra me izotope radioaktive.
Në njërën depo që është prej konstruksionit të betonit janë të vendosura reagensët e lartëcekur dhe të cilët janë në përdorim të vazhdueshëm për punën e flotacionit. Depoja tjetër me izotope radioaktive është gjithashtu me konstruksion prej betoni, e mbyllur, e siguruar dhe e shenjëzuar. Në këtë depo gjinden 3 fuqi me materie radioaktive. Fuqia 1 dhe 2 nuk janë të identifikuara, kurse në fuqinë 3 ndodhen izotopet e kobaltit (CO^{60}), dhe një kuti prej drurit në të cilën ndodhet Ceziumi ^{37}. [6]

Veprimtaria:
Prodhimi i Koncentratit të Plumbit dhe Zinkut

Tabela 9. *Lista e kimikateve në "Flotacioni Trepça"- Tuneli i Parë -Mitrovicë*

Nr.	Emri i kimikateve	Formula
1	Gëlqere	$Ca(OH)_2$
2	Soda	Na_2CO_3
3	Sulfati i Bakrit	$CuSO_4$
4	Sulfati i Zinkut	$ZnSO_4$
5	Nitrati i Natriumit	NaCN
6	Amil	Z5
7	Etil	z3
8	Dowfroth	Vaj-200

Tabela 10. *Matjet e burimeve radioaktive në "Flotacioni Trepça"- Tuneli i Parë Mitrovicë*

Matje e izotopeve		Foto	Lloji i detektorit	Ora	Vërejtje
Hyrja	0.08µ Sv/h		Indentifinder 2	10:30	
Brendësia	0.74 µ Sv/h		Indentifinder 2	10:30	
Burimet Radioaktive:	Distanca 2m-1.5 m	Distanca 2cm-1.cm	Indentifinder 2	10:30	
Fuqia 1	0.083 µ Sv/h	0.92 µ Sv/h	Indentifinder 2	10:30	Fuqia 1 dhe 2 nuk është arritur të identifikohen për shkak të izolimit dhe fuqisë së tyre.
Fuqia 2	0.110 µ Sv/h	0.170 µ Sv/h	Indentifinder 2	10:30	
Fuqia 3 Co -60	0.238 µ Sv/h	0.380 µ Sv/h	Indentifinder 2	10:30	
Kuti e drurit Cezium 137 Ind	0.190µ Sv/h	1.144µ Sv/h	Indentifinder 2	10:30	Izotop cezium 137 Ind.

[6] **Burimi**: Raporti i ekipit inspektues në përbërje nga KFOR, FSK, AKMRRSB, AME dhe MMPH-**2018**

Lloji I rrezikut në zonë				
☒ Rrezik për shpërthim	☒ Korroziv	☒ Helmues	☐ Infektues	☒ Radioaktiv




Fig.9. *Mbeturinat e rrezikshme në lokacionin e Tunelit të parë-Stan Tërg*




Fig.10. Mbeturinat e rrezikshme te Tuneli i Parë/Trepça

2.2.2. Parku Industrial Trepça - Mitrovicë[7]

Përshkrim i shkurtër:

